



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 1-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 28.01.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Arsim Jashari, anëtar
5. Egzona Bytyqi, anëtare
6. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Shkelzen Hajdini, DSH
3. Kimete Jashanica, OSBE
4. Merita Bytyqi, Sektori i Kuvendit

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se KPF-ja, është organ rekomandues, dhe me herët raportet dhe informatat nuk i kemi diskutuar hiç në KPF por i kemi votuar për kuvend, por pasi është mbledhja e parë sot, dhe drejtoret i kemi këtu po diskutojnë ne pika të shkurta. Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2021, duke u bazuar në raportet FB të datës 17.01.2022.

2. Informatë mbi Pandeminë nga Drejtorati i DSHPS-së

3. Propozim Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB.

4. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

5. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

6. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

7. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Arsim.

8. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejte kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 7 për, aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2021, duke u bazuar në raportet FB të datës 17.01.2022..

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi,i dha fjalën Latif Ramadanit DBF-s, i cili i njoftoi në pika të shkurta me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, e përkrahi këtë raport dhe uroj me te miren per qytetarët e komunës së Lipjanit

Pastaj u kalua ne pikën në vazhdim.

II

Informatë mbi Pandeminë nga Drejtorati i DSHPS-së

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën, Shkelzen Hajdini DSH, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, sistemi shëndetësor në të gjithë vendin ka qenë jo në nivel të kënaqshëm, por unë hezitoj me qenë kritikues në kohë të pandemisë. Shtëpia e shëndetit në Lipjan nuk është në gjendje të mirë, por shpresojmë në të ardhëm qoftë komuna apo ministria të bëjë ndonjë investim. Po ashtu edhe shërbimet nuk është që po kryhen aq në nivel të kënaqshëm, dhe duhet të punohet me shumë. Siç po shihet tani kanë filluar të rriten rastet e të prekurve me covid, por ne jua urojmë shërim të shpejtë.

Egzona Bytyqi, unë jam pjesë e QKMF-s, dhe dihet që ka qenë një kohë e vështirë si për stafin shëndetësor ashtu edhe për qytetarët. Kam disa pyetje sa qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë dhe tretë të vaksinës, dhe sa raste kanë qenë deri më tani në QKMF-me të cilat janë trajtuar të ne me covid, dhe sa prej tyre janë udhëzuar për në Prishtinë. Dhe kam një propozim që të jetë një tendë në oborrin e QKMF-s ku do të bëheshin testet e covid 19-të, pasi që tani këto teste bëhen në objektin e QKMF-s dhe mund të ketë përhapje me të madhe të gripit.

Fitim Shala, pajtona me disa nga parafolësit, por kam për ta ngritur një qeshje rreth ekipes mobile a do të ishte e mundur që të ishte neper teren pasi që kanë nevojë qytetarët për këtë ekipe.

Arsim Jashari, unë pajtona me parafolësit që të jemi të gjithë së bashku, rreth pandemisë, Por kam disa pyetje sa janë të vaksinuar qytetarët e Komunës së Lipjanit me dozën e parë dytë dhe tretë të vaksinës. A është mendu diçka nëse kemi shumë raste të infektimit me covid, të stafit shëndetësor, si do të bëhej zgjidhje për zëvendësimin e tyre pasi që qytetarët nuk presin.

Shkelzen Hajdini, unë i falënderoj të gjithë ata që kontribuan në këtë kohë të pandemisë, e në veçanti personelin shëndetësor. Do të kem parasysh rekomandimet të cilat u dhanë këtu. Me dozën e parë dhe të dytë kemi pas interesim të mirë për vaksinim ndërsa për dozën e tretë kemi numër të vogël të vaksinuarve. Kemi një ekipe mobile funksionale dhe ajo është në teren në shumicë rasteve.

Me qe diskutime tjera nuk pati u kalua ne pikën në vazhdim.

III

Propozim Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Arsim.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Kulturë, Rini dhe Sport

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,²⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi